

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" I MITROVICËS

FAKULTETI I GJEOSHKENCAVE

**UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
FAKULTETI I GJEOSHKENCAVE**

Pranuar me dt. 14.07.2026			
Njesia organ.	Numer	Nr.Ekzempl.	Vlera
	219/2		



PLANI STRATEGJIK I FAKULTETIT TË GJEOSHKENCAVE

2026-2030

Korrik 2026

PËRMBAJTJA	
Shkurtesat	3
Fjala e Dekanit	4
HARTIMI I PLANIT STRATEGJIK I FAKULTETIT TË GJEOSHKENCAVE	5
HYRJE	6
HISTORIKU DHE PROFILI I FAKULTETIT GJEOSHKENCAVE	7
NEVOJAT DHE MUNDËSITË NË FAKULTETIN E GJEOSHKENCAVE	8
PROCESI I PLANIFIKIMIT STRATEGJIK	9
Misioni	9
Visioni	9
RESURSET NJERËZORE DHE STUDENTËT	10
OBJEKTIVAT STRATEGJIKE	11
SWOT Analiza	11
PLANI I VEPRIMIT	13

Shkurtesat:

IMGC	International Multidisciplinary Geo-Science Conference
KQSCV	Komisioni qendror për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimit
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
PBNKSH	Prorektori për bashkëpunim ndërkombëtar dhe kërkime shkencore
PSUMIB	Plani Strategjik i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”
UIBM	Universiteti “Isa Boletini” ne Mitrovicës
ZBN	Zyra për bashkëpunim ndërkombëtar
ZÇA	Zyra për çështje akademike
ZP	Zyra e personelit
ZSC	Zyra për Sigurim të Cilësisë

Fjala e Dekanit

Të nderuar,

Fakulteti i Gjeoshkencave është institucioni i vetëm i Arsimit të Lartë në Kosovë që edukon ekspertë kompetent dhe kryen kërkime shkencore e profesionale në fushën e Gjeologjisë, Xehetarisë dhe Materiale dhe Metalurgji. Me aktivitetet e tij, Fakulteti, vazhdimisht, kontribuon në zhvillimin dhe avancimin e profesionistëve në fushën e gjeoshkencave. Zhvillimi i fakultetit lidhet ngushtë me avancimin dhe përvojën akademike të studentëve dhe stafit. Ky plan strategjik përcakton rrugët e artikuluara qartë për forcimin dhe zgjerimin e fakultetit.

Zhvillimi i këtij Plani Strategjik është rezultat i punës së disa viteve përmes një seri konsultimesh me menaxhmentin, stafin akademik, stafin administrativ, studentë, përfaqësues të institucioneve, industrisë dhe alumni. Ky Plan Strategjik është rrjedhojë e rishikimit të planeve strategjike të mëparshme dhe i harmonizuar me Planin Strategjik të Universitetit. Për këtë qëllim u krijua Grupi punues i palëve të interesit për të shqyrtuar dhe përcaktuar objektivat të cilat janë në përputhje me misionin dhe vizionin e fakultetit.

Qëllimi i punës rreth përpilimit të Planit Strategjik ishte të kishim një strategji sa më të thjeshtë dhe të qartë për të gjithë personelin dhe palët e interesit që lidhet me të në mënyrë që të kemi detyrat e qarta përpara dhe të ndiejmë se po punojmë për të njëjtat synime.

Si rezultat i punës së të gjithëve, ne kemi një Plan Strategjik të qartë me një sërë objektivash dhe aktiviteteve që reflektojnë kontributin tuaj të rëndësishëm. Unë dëshiroj të falenderoj të gjithë për kontributin, përvojën, kohën dhe kujdesin.

Kemi shumë për të bërë për zbatimin e këtij Plani Strategjik në drejtim të avancimit drejt misionit dhe vizionit ambicioz që kemi për Fakultetin tonë.

Me respekt,

Prof. asoc. dr. Festim Kutllovci, dekan

HARTIMI I PLANIT STRATEGJIK I FAKULTETIT TË GJEOSHKENCAVE

Plani strategjik i përpiluar, për periudhën kohore 2026-2030 i Fakultetit të Gjeoshkencave është hartuar duke u mbështetur në vazhdimësinë të Planit Strategjik paraprak të Fakultetit Gjeoshkencave dhe Planit Strategjik të Universitetit “Isa Boletini” të Mitrovicës 2026–2030. Ky Plan Strategjik është përpiluar në konsultimin gjithëpërfshirës të akterëve të jashtëm dhe të brendshëm të Komisionit Profesional, i cili u emërua sipas Vendimit numër protokoli 74 të datës 26.02.2026 të Këshillit të Fakultetit të Gjeoshkencave, në përbërje prej 18 anëtarëve:

1. Festim Kutllovci, dekan FGJ - kryetar,
2. Kemajl Zeqiri, prodekan FGJ - anëtar
3. Afrim Osmani, prodekan FGj – anëtar
4. Mimoza Abazi, Sekretare FGj - anëtare
5. Bastri Zeka, shef Departamenti Materiale dhe Metalurgji - anëtar,
6. Ariana Sadiku, shef Departamenti Xehetari - anëtar,
7. Gzim Ibishi, profesor - anëtar,
8. Astrit Shala, profesor - anëtar,
9. Arber Zeqiraj, asistent - anëtar,
10. Sebahate Shala, përfaqësuese e studentëve – anëtare.
11. Leonis Zenullahu, përfaqësues i studentëve - anëtar,
12. Skender Sallahi, Ministria Ekonomisë, ShGjK - anëtar,
13. Shefik Imeri, Trupi Këshilldhënës – anëtar
14. Faruk Beqiri, Trupi Këshilldhënës, NewCo Ferronikeli – anëtar,
15. Fatmir Gërguri, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) – anëtar
16. Enes Muzaqi, Trepça sh.a, Alumni - anëtar,
17. Burim Asllani, MLK Mining, Alumni - anëtar.
18. Edmond Pllana, ACHRO SHPK, përfaqësues biznesi - anëtar,

Fakulteti i Gjeoshkencave është një njësi akademike që funksionon në kuadër të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë me programe unike që nuk ekzistojnë në ndonjë institucion të Arsimit të Lartë në Kosovë. Ne jemi krenar për punën tonë, në kuadër të Arsimit të Lartë në Kosovë, për këto drejtime specifike në fushën e Gjeologjisë, Xehetarisë dhe Materiale & Metalurgji.

Tradita e Arsimit të Lartë në Mitrovicë, daton qysh nga vitin 1961, me hapjen Shkollës së Lartë Teknike duke vazhduar veprimtarinë e arsimit deri në themelimin e Fakultetit. Kështu, Fakulteti i Gjeoshkencave në Mitrovicë (ish Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë, pjesë e Universitetit të Prishtinës) është themeluar në vitin 1974. Fakulteti filloi punën, në vitin shkollor 1974/1975, në këto drejtime: Xehetari, Metalurgji, dhe Teknologji. Ndërsa, pesë vite më vonë, hapet edhe drejtimi i Gjeologjisë, në vitin akademik 1980/1981. Qysh nga themelimi e deri më tani, Fakulteti i Gjeoshkencave ka luajtur një rol mjaft të rëndësishëm në arsimimin dhe përgatitjen e kuadrove të reja, si dhe qasja në hulumtime shkencore - profesionale në fushën e Gjeologjisë, Xehetarisë, dhe Materiale dhe Metalurgjisë, në bazë të kërkesave industriale të vendit. Kështu, pesë vite pas themelimit të Universiteti të Mitrovicës, në fund të vitit 2018, Fakulteti i Gjeoshkencave kalon në kampusin e ri universitar me një infrastrukturë moderne ndërtimore. Ndërtesat e reja dhe investimet që po bëhen në laboratore ofrojnë shumë mundësi për të investuar më tej në arsim dhe hulumtime shkencore me cilësi më të lartë.

Zhvillimi i programeve akademike në nivel të Universitetit bazohet në planin strategjik të Fakultetit. Plani strategjik i Fakultetit të Gjeoshkencave në mënyrë shumë të qartë përcakton planet dhe ambiciet tona për periudhën afatmesme 2026-2030. Harmonizimi i Planit Strategjik të Fakultetit të Gjeoshkencave është bazuar në Planin Strategjik të Universitetit për të njëjtën periudhë kohore, duke shërbyer si kornizë për strategjinë e Fakultetit.

Plani Strategjik ofron një përshkrim më të përgjithshëm të asaj që duam të arrijmë dhe si planifikojmë ta arrijmë atë. Përmes këtij plani jemi munduar të sqarojmë pse këto ambicie janë reale dhe gjithashtu të përshkruajmë se si Fakulteti planifikon të zbatojë këto ambicie. Gjatë fazës së ardhshme të Strategjisë, ne do të vazhdojmë të zhvillojmë partneritetin tonë me universitete, institucione, industrinë, bizneset vendore e ndërkombëtare me një bashkëpunim që ndërlihd kërkimin si bazë e zhvillimeve rajonale e globale. Plani Strategjik është rezultat i diskutimeve të shumta të akterëve të ndryshëm si: stafi akademik, stafi administrativ, studentë, përfaqësues të institucioneve, industrisë dhe alumni. U organizuan takime dhe konsultime të shumta dhe në fund është aprovuar nga Këshilli Fakultetit.

HISTORIKU DHE PROFILI I FAKULTETIT GJEOSHKENCAVE

Që nga vitet e 1960, Fakulteti i Gjeoshkencave në Mitrovicë ka edukuar ekspertë kompetentë dhe ka mundësuar kryerjen e kërkimeve profesionale dhe shkencore në fushën e Gjeologjisë, Xehetarisë dhe Materiale dhe Metalurgji, në bazë të rrethanave sociale dhe ekonomike. Zhvillimi i profesioneve të cekura në Kosovë është i varur në masë të madhe nga aktivitetet e Fakultetit, derisa stafi i fakultetit, gjatë gjithë kohës në vazhdimësi, ka kontribuar në prosperitetin e këtyre profesioneve në veçanti, si dhe të tërë shoqërisë në përgjithësi.

Fakulteti i Gjeoshkencave tani funksionin në kuadër të Kampusit të ri të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”.

Objektet e reja të kampusit universitar sjellin mundësi të reja për organizimin e gjerë të punës mësimore dhe hulumtuese shkencore. Ky kampus ka hapësira të mjaftueshme të sipërfaqeve për: punët eksperimentale (laboratorët), hapësirat mësimore, punët teorike, biblioteka, hapësira komunikuese, hapësira për ekspozimin e gjeomaterialeve dhe hapësira të tjera shërbyese.

Sipërfaqja e përgjithshme e shfrytëzueshme e Fakultetit të Gjeoshkencave përfshin rreth 3980,37 m².



Kampusi i Universitetit të Mitrovicës

Programet e studimit që ofrohen në Fakultetin e Gjeoshkencave.

Programi i studimeve		Niveli i studimeve	Prej	Deri
Fakulteti i Gjeoshkencave	Gjeologji	BSc	01.10.2024	30.09.2029
	Inxhinieria Minerare	BSc	01.10.2025	30.09.2028
	Materiale dhe Metalurgji	BSc	01.10.2024	30.09.2027
	Hidrogjeologji me Gjeologji Inxhinerike	MSc	01.10.2024	30.09.2027
	Vendburimet Minerale	MSc	01.10.2025	30.09.2028
	Zhvillimi i Qëndrueshëm i Minerave	MSc	01.10.2025	30.09.2028
	Materiale dhe Metalurgji	MSc	01.10.2024	30.09.2027

NEVOJAT DHE MUNDËSITË NË FAKULTETIN E GJEOSHKENCAVE

Gjeo-shkencëtarët e dekadave të ardhshme do të përballen me çështje lokale, nacionale dhe globale të ndërlidhura me zvogëlimin e resurseve minerale dhe energjetike, resurset ujore, rreziqet natyrore, si dhe vlerësimin e hapësirave për projekte infrastrukturore dhe zonave banuese. Përpjekjet e tyre duhet të ndërlidhen me sfidat mjedisore për të mbrojtur kualitetin jetësor, duke menaxhuar një zhvillim në një botë gjithnjë e më të populluar.

Fakulteti i Gjeoshkencave duhet të sigurojë kuadro që kuptojnë proceset, të cilat zhvillohen në Tokë dhe kanë aftësi për ofrim të zgjidhjes së problemeve në mjedisë pune ndër-diciplinare. Ata duhet të komunikojnë në mënyrë efektive me inxhinierë, shkencëtarë mjedisorë dhe planifikues, dhe njëkohësisht duke edukuar publikun rreth lidhjeve në mes pjesës së ngurtë të Tokës dhe hidrosferës, atmosferës dhe biosferës së saj.

Strategjia e zhvillimit të vendit e bazuar në zhvillimin e resurseve minerale kërkon kuadro gjeologjike të minierave dhe materiale/metalurgji, të cilat përveç njohurive në kërkim, zbulim, shfrytëzim dhe përpunim të resurseve, duhet të posedojnë edhe aftësitë e ballafaqimit me problemet e ndryshme mjedisore. Zhvillimi i planeve hapësinore, sigurimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve minerale, mbrojtja nga rreziqet natyrore dhe sigurimi i kushteve mjedisore janë segmente shumë të rëndësishme për vendin të cilat kërkojnë njohurin e gjeo-shkencëtarëve. Nisur nga këto fakte, dhe jo vetëm, gjeo-shkencëtarët do të jenë një kuadër i kërkuar në rritje.

Fakulteti i Gjeoshkencave është i angazhuar për të siguruar programe arsimore dhe kërkimore në dobi të studentëve, shkencës, shoqërisë dhe shtetit të Kosovës. Misioni i Fakultetit të Gjeoshkencave është i dhënë përmes synimeve në vazhdim:

- Zhvillimi i programeve arsimore kualitative për përgatitjen e studentëve për edukim dhe karrierë në shkencat e Gjeologjisë, Xehetarisë dhe Metalurgji dhe Materialeve.
- Ngritja e kuadrove profesionale në fushat e Gjeologjisë, Xehetarisë dhe Metalurgjisë përmes zbatimit të metodave moderne të edukimit dhe hulumtimit.
- Zhvillimi i programeve kualitative që u sigurojnë studentëve MSc. dhe PhD aftësi të nevojshme për punë të pavarur kërkimore dhe mundësi punësimi në fusha të specializuara të gjeoshkencave.
- Zhvillimi dhe mirëmbajtja e programeve kërkimore që kontribuojnë në njohuri të reja të gjeoshkencave dhe ndihmojnë në një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit.

PROCESI I PLANIFIKIMIT STRATEGJIK

Plani Strategjik i Fakultetit të Gjeoshkencave është përpiluar dhe rishikuar duke iu përshtatur planeve zhvillimore të Universitetit dhe Fakultetit. Plani Strategjik 2026 - 2030 është harmonizuar me Planin Strategjik të Universitetit 2026-2030.

Grupi punues i formuar për harmonizimin e Planit Strategjik 2026-2030 (i përbërë nga menaxhmenti i Fakultetit, përfaqësues të personelit akademik dhe administrativ të Fakultetit Gjeoshkencave, përfaqësues nga Industria, përfaqësues të studentëve dhe Alumni) ka bërë rishikim dhe harmonizimin e Planit me Planin Strategjik të Universitetit.

Grupi punues, gjatë tërë kohës së hartimit të Planit Strategjik, kanë marrë ide dhe sygjerime nga tërë personeli, si dhe palët e tjera të interesit.

Plani Strategjik paraqet një dokument, i mbështetur në punën ekipore të personelit fakultetit dhe palëve të interesit. Përpilimi i tij është bazuar në vizionin dhe misionin e Fakultetit që kanë shërbyer si udhërrëfyes për objektivat strategjike të fakultetit.

Misioni

Misioni i Fakultetit është ruajtja dhe zhvillimi i programeve unike të Fakultetit Gjeoshkencave duke prodhuar të diplomuar që janë të arsimuar për të luajtur një rol të rëndësishëm në fusha të gjeoshkencave në përgjigje të nevojave shoqërore, kryejnë kërkime bazë dhe të aplikuara bazuar në specialitetin e fakultetit për nevoja shkencore dhe industrisë si dhe bashkëpunimi arsimor me Universitetin, komunitetin dhe shoqërinë në tërësi për ndërgjegjësimin publik në fushën e gjeoshkencave.

Visioni

Fakulteti i Gjeoshkencave synon të sigurojë nivelet më të larta të arsimit përmes rishikimit dhe zgjerimit të programeve arsimore, kërkimore dhe informimit të vazhdueshëm, në mënyrë që të prodhojë gjeologë, xehetarë dhe metalurgë të trajnuar mirë, kompetentë, akademikë dhe profesionalë për t'iu përgjigjur nevojave të shoqërisë.

RESURSET NJERËZORE DHE STUDENTËT

Resurset humane dhe studentët paraqesin pasurinë më të rëndësishme të Fakultetit, prandaj meritojnë vëmendje në strategjinë tonë.

Personeli akademik – janë bartësit kryesorë për zhvillimin e fakultetit. Janë përgjegjës për procesin mësimor efektiv, këshillimit akademik dhe këshillimit të studentëve, si dhe për zhvillimin e vazhdueshëm të kurrikulës përmes vlerësimit, veprimtarisë studimore, kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

Personeli akademik bazuar në titujt akademik

	Profesorë të rregullt	Profesorë të asocuar	Profesorë Asistent	Ligjërues	Asistent	Total
Të rregullt	16	7	5	-	5	33
Të angazhuar	-	-	-	-	5	5

Personeli administrativ dhe teknik - kryejnë funksionet operacionale dhe administrative të fakultetit dhe departamenteve, shërbimet studentore dhe bibliotekës. Këtu përfshihen: sekretari i fakultetit, administrata për shërbimin e studentëve, bibliotekisti, protokoli dhe arkivi, si dhe personeli teknik.

Menaxhmenti i fakultetit - Menaxhmenti i fakultetit përbën organet udhëheqëse dhe vendim-marrëse që përkujdesen për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e punës edukative, kërkimit shkencor, sigurimit të cilësisë, bashkëpunimit ndërkombëtar, si dhe menaxhimit financiar. Në këtë grup bëjnë pjesë: Këshilli Fakultetit, dekani, prodekanët dhe shefat e departamenteve.

Studentët – Fakulteti konsideron që studentët paraqesin palën më thelbësore të interesit dhe duhet të jenë përfituesit më të mëdhenj të funksionimit dhe zhvillimit të fakultetit. Studimet duhet t'u sigurojnë atyre një pasqyrë në shumëllojshmërinë e vizioneve dhe qasjeve që ekzistojnë në vend, rajon e botë. Ne dëshirojmë që studentët që studiojnë në Fakultetin Gjeoshkencave mund t'u përshtaten komunitetit të gjeoshkencave, në aspektin profesional, dhe mund të bashkangjiten në jetën e tyre të punës. Gjithashtu, është e rëndësishme që ata të ndihen të akomoduar brenda këtij komuniteti.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Plani Strategjik identifikon objektivat strategjike të zhvillimit të Fakultetit për periudhën afatmesme 2026-2030 të zhvillimit.

Ngritja akademike nëpërmjet programeve bashkëkohore - avancimi i metodave të mësimdhënies, zhvillimi i një kurrikule moderne me theks në fushat e zhvillimit strategjik, rritja e aktivitetit akademik, përmirësimi i studimeve nëpërmjet përdorimit të laboratorëve bashkëkohorë dhe pajisjeve në terren, zhvillimi i programeve të reja Bachelor, Master dhe programet e doktoraturës

Hulumtimi Shkencor - hartimi i planit strategjik të kërkimeve shkencore, krijimi i fondit nga të hyrat financiare për përkrahje të hulumtimit, organizimi i konferencës së FGJ.

Promovimi i FGJ-së, misioni dhe rëndësia e tij në vend - Përfshirja e FGJ-së në hulumtime dhe ngjarje me rëndësi të drejtpërdrejtë për shoqërinë, promovimi i FGJ-së, bashkëpunimi vendor dhe ndërkombëtar i FGJ-së,

Ndërtimi i sistemit të sigurimit të cilësisë - Përmes metodave praktike të mësimin, hulumtimeve shkencore dhe praktikave të ndryshme në institucione dhe industri, studentët do të fitojnë aftësi të zbatueshme për karrierë në shkencat e Tokës dhe disiplina të ndërlidhura. Programet e Departamenteve, me theks në kuptimin e proceseve të sistemit Tokë dhe ndërlidhjet e tyre, sigurimin dhe procedimin e resurseve minerale në mënyrë të qëndrueshme, do t'u mundësoj studentëve sigurimin e një perspektive globale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve, marrjen e vendimeve, dhe rolet udhëheqëse në një botë që po ndryshon me shpejtësi dhe po ballafaqohet me sfidat e mjedisit.

SWOT Analiza

Fuqitë	Dobësitë
1. Programet unike që ofron FGJ kanë ndikuar në zhvillimin e industrisë në rajonin e Mitrovicës dhe më gjerë 2. Kampusi më i ri, Infrastrukturë themelore e shkëlqyeshme (laboratorë, zyra, punëtori etj), 3. Personel kompetent nga stafi akademik dhe administrative, 4. Programe të akredituara, 5. Themelimi dhe funksionalizimi Institutit të	1. Buxheti jo i mjaftuar për hulumtime dhe kërkime shkencore, 2. Mungesa e programeve të doktoratës, 3. Kufizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe mobilitet sidomos të projekteve COST, ku Kosova nuk është anëtarë e plote, 4. Shumë pak financime të jashtme, 5. Shkalla e lartë e braktisjes (studime BSc),

Gjeoshkencave - Mjedisi i shkëlqyer për studentët, - Lidhje e mirë në mes të edukimit dhe industries, - Kosto e ulët dhe e përballueshme e studimit për studentë, - Përfshirja e studentëve në të gjitha strukturat vendimmarrëse të fakultetit, - Konsultimi i gjerë me komunitetin e biznesit, studentët Alumni dhe punëdhënësit e tyre, - Gatishmëria e stafit për bashkëpunim me studentë.	
Mundësitë	Rreziqet
- Rritja e punëve hulumtuese, - Forcimi i programeve dhe hulumtimeve ndërdisiplinare, - Rritja e numrit të aplikantëve të BSc, - Sigurimi i mundësive për programe të reja sipas interesave lokale dhe kombëtare, - Trajnimi i stafit me metodologjitë e mësimdhënies në Arsimin e Lartë, - Bashkëpunimi me komunitetin për sfidat mjedisore nga aktiviteti mineral, - Hapja e programeve studimore në gjuhën angleze.	- Numri i vogël i studentëve, - Mos zhvillimi i sektorit mineral, - Migrimi i të rinjve.

Objektivat strategjike

Objektivi 1: Ngritja akademike nëpërmjet programeve bashkëkohore;

Objektivi 2: Hulumtimi Shkencor;

Objektivi 3: Promovimi i FGJ-së, misioni dhe rëndësia e tij në vend;

Objektivi 4: Avancimi i sistemit të sigurimit të cilësisë.

Plani Strategjik përmban në vetvete Planin e Veprimit. Në kuadër të Planit të Veprimit janë paraqitur objektivat strategjike. Me qëllim të lehtësimit të zbatimit me efikasitet dhe monitorimit të Planit Strategjik, Plani i Veprimit përmban edhe indikatorët (treguesit) kryesorë të performancës.

PLANI I VEPRIMIT

Objektiva strategjike: 1. Ngritja akademike nëpërmjet programeve bashkëkohore						
Objektiva specifike: 1.1. Avancimi i metodave të mësimdhënies						
Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës	
1.1.1 Trajnim për metodologjitë e reja të mësimdhënies	FGJ	1,000.00 €	Trajnimet e organizuara	2026-2030	Stafi i trajnuar	
1.1.2 Trajnim i avancuar për metodologjitë e mësimdhënies	FGJ	1,000.00 €	Trajnimet e organizuara	2027 -2030	Stafi i trajnuar	
1.1.3 Përshtatja e syllabuseve me zhvillimet në domenin specifik	FGJ	Shpenzime administrative	Numri i syllabuseve të shqyrtuara	2026-2030	100% e syllabuseve të përditësuara	
Objektiva specifike: 1.2. Zhvillimi i një kurrikule moderne me theks në fushat e zhvillimit strategjik.						
Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës	
1.2.1. Ri-shikimi i planeve mësimore dhe programeve të aplikueshme	ZSC, FGJ	Shpenzime administrative	Numri i planeve/programeve mësimore	2026-2030	Planet/programet e ri-shikuara	
Objektiva specifike: 1.3. Rritja e aktivitetit akademik						
1.3.1. Analizimi i rezultateve	ZSC, FGJ	Shpenzime administrative	Numri i pyetësorëve të analizuar	2026 - 2030	Raporti me gjetjet	

nga pyetësorët me stafin akademik;						
1.3.2. Analizimi i rezultateve nga pyetësorët për matjen e cilësisë me studentët: Një në përfundim të çdo semestri	ZSC, FGJ	Shpenzime administrative	Numri i pyetësorëve të analizuar	2026 - 2030	Raporti me gjetjet	
1.3.3. Analizimi i rezultateve nga pyetësorët për matjen e cilësisë me menaxhmentin e UMIB-it	ZSC, FGJ	Shpenzime administrative	Numri i pyetësorëve të analizuar	2026 - 2030	Raporti me gjetjet	
Objektiva specifike: 1.4. Përmirësimi i studimeve nëpërmjet përdorimit të laboratorëve bashkëkohorë dhe pajisjeve në terren.						
Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës	
1.4.1. Sigurimi dhe mirëmbajtja e laboratorëve bashkëkohorë dhe pajisjeve të punës në terren,	UMIB.FGJ ,	300,000.00€	Blerja e pajisjeve për mësim dhe hulumtim, Kontratat e mirëmbajtjes	2026-2030	Laboratorët e furnizuar me pajisje	
1.4.2. Lehtësimi i qasjes së studentëve në laboratorë dhe aktivitete në terren	UMIB.FGJ	3,000€	Përmirësimi i raportit në mes të pjesës praktike dhe teorike	2026-2030	Realizimi i praktikës sipas syllabusit	
Objektiva specifike: 1.5. Zhvillimi i programeve të reja master dhe programet e doktoraturës						
Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës	

1.5.1 Analizimi dhe vlerësimi i nevojave në vend për programe të reja	UMIB-Senati FGJ	Shpenzime administrative	Numri i programeve të reja master	2026-2030	Nje programi ri
1.5.2 Aktivitete për hartimin e Rregullores për studime të doktoraturës	UMIB, FGJ	Shpenzime administrative	Hartimi i Rregullores	2026	Rregullorja e hartuar
Objektiva strategjike: 2. Hulumtimi Shkencor					
2.1. Hartimi i planit strategjik të kërkimeve shkencore					
Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
2.1.1. Formimi i grupit punës dhe hartimi i planit strategjik të kërkimeve shkencore në FGJ	FGJ	Shpenzime administrative	Hartimi dokumentit "Plani Strategjik për kërkime shkencore"	2026-2027	Dokumenti i Planit Strategjik për kërkime shkencore i hartuar
2.1.2 Akreditimi i laboratoreve Institutit Gjeoshkencave (IGJ)	UMIB, FGJ	4500.00	Certifikata akreditimit	2026-2030	Laboratore të certifikuara
2.1.3 Certifikim i laborantëve	UMIB, FGJ	1200.00	Certifikata laborantëve	2026-2030	Laborantë Certifikuar
2.1.4 Hartimi i planit strategjik të Institutit duke siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe vlerë të lartë në projekte kërkimore-hulumtuese/profesionale	UMIB, FGJ	Shpenzime administrative	Sigurimi i cilesise ne projekte hulumtuese/ profesionale qendrueshmeria afatgjate e Institutit	2026-2030	Instituti funksional në FGJ

2.2. Krijimi i fondit nga të hyrat financiare për përkrahje të hulumtimit					
Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
2.2.1. Aplikimi për përkrahje nga skemat e ndryshme të MASHTI-t dhe partneritet në projekte të përbashkëta ndërkombëtare	Instituti kërkimor, FGJ, Shtati akademik dhe studentët	Shpenzime administrative	Aplikimet për projekte dhe përkrahje	2026-2030	5 aplikime
2.3. Organizimi i konferencës së FGJ					
2.3.1. Organizimi i edicionit vjetor të Konferencës multidisciplinare dhe ndërkombëtare në Gjeoshkenca	Këshilli organizativ	8,000.00 €	Rritja e numrit të pjesëmarrësve dhe punimeve shkencore në eventin IMGC në vazhdimësi	2026-2030	10% më shumë pjesëmarrës nga vendi dhe jashtë vendit nga edicionet e mëparshme
Objektiva strategjike: 3. Promovimi i FGJ-së, Misioni dhe rëndësia e tij në vend					
Objektiva specifike: 3.1. Përfshirja e FGJ-së në hulumtime dhe ngjarje me rëndësi të drejtpërdrejtë për shoqërinë					
Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
3.1.1. Organizimi i eventeve të përbashkëta lidhur me ngjarjet në FGJ, me qëllim të intensifikimit të bashkëpunimit mes Alumnit, Bordit Industrial	UMIB FGJ, Bordi Industrial,	3000.00 €	Numri i eventeve dhe aktiviteteve me Alumnin, Bordin Industrial dhe përfaqësuesit e industrisë në ngjarjet e Universitetit/Fakulteteve	2030 - 2030	Së paku dy aktivitete në vit me institucione të tjera vendore.

dhe përfaqësuesve të industrisë						
3.1.2 Përfshirja e studentëve në projekte dhe teza masteri me lidhje të drejtpërdrejta me industrinë lokale dhe çështje të komunitetit	FGJ	Shpenzime administrative	Projekte dhe teza të masterit të bazuara në interesat dhe çështjet lokale	2026-2030		Rritja e pjesëmarrësve në projekte dhe industri
3.1.3 Krijimi i ALUMNIT në kuadër të Fakultetit të Gjeohkencave	FGJ	Shpenzime administrative	Lista e ALUMNI për FGJ	2028		Aktivitetet ALUMNI FGJ
Objektiva strategjike: 3.2. Provomimi i FGJ-së						
3.2.1. Hartimi i broshurave për studentë me informatat më relevante që kanë të bëjnë me Fakultetin dhe programet e studimit.	FGJ	2.000,00€	Broshura e hartuar	2026-2030		Broshura e publikuar në web-faqe
3.2.2 Kampanjë informuese për maturantët	FGJ Këshilli i studentëve	1500.00 €	Numri i aktiviteteve të kampanjës	2026-2030		3 aktivitete të realizuara
Objektiva specifike: 3.3. Bashkëpunimi vendor dhe ndërkombëtar i FGJ-së						
Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor		Rezultati i pritur i performancës
3.3.1. Anëtarësim në shoqata të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare	FGJ, PBNKSH, ZBN	1,000.00 €	Numri i anëtarësimeve në shoqata ndërkombëtare	2026-2030		2 anëtarësime të reja/vit

3.3.2. Përkrahja e stafit për pjesëmarrje në Konferenca shkencore	FGJ, PBNKSH, ZBN	5,000.00 €	Numri i stafit akademik i përkrahur për pjesëmarrje në konferenca/vit.	2026-2030	Ngrija e numrit të personelit akademik të FGJ-së si pjesëmarrës
3.3.4. Pjesëmarrja e personelit akademik/administrativ dhe studentëve në ngritjen e kapaciteteve profesionale për aplikim për mobilitet ndërkombëtar	FGJ	Shpenzime administrative	Numri i punëtorëve të mbajtura për ngritjen e kapaciteteve për aplikime për mobilitet	2026-2030	Një punëtori në vit për përfaqësues të stafit akademik dhe studentëve
3.3.5. Përcaktimi i lëndëve dhe organizimi i mësimit për lëndët me vlerë 15 kredi që do të ligjërohen në gjuhën Angleze	FGJ	Shpenzime administrative	Numri i lëndëve	2026-2030	Minimumi 6 lëndë
Objektiva strategjike: 4. Avancimi i sistemit të sigurimit të cilësisë					
Objektiva specifike 4.1 Zhvillimi i sistemit të sigurimit të cilësisë në FGJ					
Aktivitetet	Njësitë përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja financiare (EUR)	Treguesi kryesor i performancës	Afati kohor	Rezultati i pritur i performancës
4.1.1 Implementimi i Udhëzuesit për sigurim të cilësisë në punën e FGJ-së	FGJ	Shpenzime administrative	Analiza e rezultateve të arritura nga puna e vlerësuar	2026-2030	Rezultatet e publikuara në web-faqe

